



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BORDI I DREJTIMIT
TË ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

URDHËR

Nr. 2, datë 27 02 2013

PËR

“PËRFSHIRJEN NË INVENTAR TË VLERËS SË GODINAVE DHE TROJEVE NË NJËSITË
SHPENZUESE TË GJYQËSORIT”

Në zbatim të Ligjit Nr.8363, datë 01.07.1998 “Për Krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, neni 6 dhe 9; Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 2 dhe 19; Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 3 dhe 8 si dhe Ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” neni 3, 7 dhe 10; në kuadër të identifikimit, vlerësimit, monitorimit dhe shmangies së risqeve nga mosevidentimi në inventarin e çdo njësie shpenzuese, të vlerës së ndërtesave dhe trojeve të gjykatave;

URDHËROJ:

1. Të kalohet në inventarin ekonomik dhe të përfshihen në pasqyrat financiare të cdo njësie shpenzuese, për vitin 2012, vlera historike e ndërtesave dhe trojeve të tyre si dhe amortizimi i akumuluar.
2. Të udhëzohen gjykatat, për regjistrimin në vijim të këtyre aktiveve, në regjistrin e aktiveve të institucionit.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E GJYKATËS SË LARTË
KRYETARE E BORDIT DREJTUES
TË ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

SHPRESA BEÇAJ

